

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 129 Prot.

Tiranë, më 30.01 2017

VENDIM Nr. 14, datë 24.01.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbllimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1 të datës 24.01.2017, pasi shqyrtoi *Raportin e sondazheve arkeologjike në korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit - TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)* në zonën e Leshnjës, KM 59+ 000, KM 61+000, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Raportin e sondazheve arkeologjike në korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit - TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)* në zonën e Leshnjës, KM 59+ 000, KM 61+000, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., të marrë masat për rehabilitimin e zonës.
3. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazsjellësit TAP, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 99, datë 14.09.2016, për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Dytë, KM 0 - KM 69".
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KAMBAROFLURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO